

**Rregullore e Promocionit “Fifa World Cup” të organizuar nga  
“Coca-Cola Bottling Shqipëria” (CCBS)**

1. Subjekti organizues i promocionit **“Loja Promocionale Fifa World Cup”** është shoqëria Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk (CCBS), NUIS J61901061H, me seli në adresën: Rr. Kombëtare Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, Tiranë.
2. Promocioni **“Loja Promocionale Fifa World Cup”** do të zhvillohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Në promocionin **“Loja Promocionale Fifa World Cup”** mund të marrin pjesë të gjithë personat fizikë me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, mbi 18 Vjec, të cilët do të blejnë produktet Coca-Cola Origjinale në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L , Coca-Cola Zero në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Orange në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Orange Zero në paketimet kanaçe 330ml, shishe PET 1.5L, Fanta Exotic në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Lemon në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L dhe PET 1.5L, Sprite në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L, shishe Qelq RGB 0.25L, Schweppes Indian Tonic në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, PET 0.9L, shishe Qelq RGB 0.25L, Schweppes Bitter Lemon në paketimet kanaçe 330ml, PET 0.9L, Schweppes Grape Fruit në paketimin kanaçe 330ml, Schweppes SodaWater në paketimin kanaçe 330ml, Powerade Orange në paketimin PET 0.5L, Powerade Mount Blast në paketimin PET 0.5L, Powerade Citrus në paketimin PET 0.5L pergjate periudhes se promocionit 08 Qershor 2026 - 17 Korrik 2026. Produktet e sipërpermendura duhet të jene të prodhuara nga/për Coca-Cola Bottling Shqipëria shpk.
4. Produktet e CCBS të përfshira në këtë promocion do të shiten me çmimin normal të tregut. Çmimi i rekomanduar i tregut per keto produkte gjendet në tabelën me poshte:

Emertimi	Formati	Cmimi I Rekomanduar (Pa TVSH)	Cmimi I Rekomanduar per cope (me TVSH)
Coca-Cola Origjinale Shije	Kanace 150 ml	ALL 37.50	ALL 45.00
Coca-Cola Origjinale Shije	Qelq RGB 250 ml	ALL 125.00	ALL 150.00
Coca-Cola Origjinale Shije	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Coca-Cola Origjinale Shije	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Coca-Cola Origjinale Shije	PET 0.9L	ALL 83.33	ALL 100.00
Coca-Cola Origjinale Shije	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Coca-Cola Origjinale Shije	PET 2L	ALL 166.67	ALL 200.00
Coca-Cola Zero	Kanace 150 ml	ALL 37.50	ALL 45.00
Coca-Cola Zero	Qelq RGB 250 ml	ALL 125.00	ALL 150.00
Coca-Cola Zero	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Coca-Cola Zero	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Coca-Cola Zero	PET 0.9L	ALL 83.33	ALL 100.00
Coca-Cola Zero	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Fanta Orange	Kanace 150 ml	ALL 37.50	ALL 45.00

Fanta Orange	Qelq RGB 250 ml	ALL 125.00	ALL 150.00
Fanta Orange	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Orange	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Orange	PET 0.9L	ALL 83.33	ALL 100.00
Fanta Orange	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Fanta Orange	PET 2L	ALL 166.67	ALL 200.00
Fanta Exotic	Kanace 150 ml	ALL 37.50	ALL 45.00
Fanta Exotic	Qelq RGB 250 ml	ALL 125.00	ALL 150.00
Fanta Exotic	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Exotic	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Exotic	PET 0.9L	ALL 83.33	ALL 100.00
Fanta Exotic	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Fanta Exotic	PET 2L	ALL 166.67	ALL 200.00
Fanta Lemon	Kanace 150 ml	ALL 37.50	ALL 45.00
Fanta Lemon	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Lemon	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Lemon	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Fanta Orange Zero	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Fanta Orange Zero	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Sprite	Qelq RGB 250 ml	ALL 125.00	ALL 150.00
Sprite	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Sprite	PET 0.45L	ALL 66.67	ALL 80.00
Sprite	PET 0.9L	ALL 83.33	ALL 100.00
Sprite	PET 1.5L	ALL 133.33	ALL 160.00
Schweppes Indian Tonic	Kanace 150 ml	ALL 44	ALL 55
Schweppes Indian Tonic	Qelq RGB 250 ml	ALL 104	ALL 130

Schweppes Bitter-Lemon	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80.00
Schweppes Grapefruit	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80
Schweppes Indian Tonic	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80
Schweppes Soda Water	Kanace 330 ml	ALL 66.67	ALL 80
Schweppes Indian Tonic	PET 0.9L	ALL 96.00	ALL 120
Schweppes Bitter-Lemon	PET 0.9L	ALL 96.00	ALL 120
Powerade Orange	PET 0.5L	ALL 88	ALL 110
Powerade Mount Blast	PET 0.5L	ALL 88	ALL 110
Powerade Citrus	PET 0.5L	ALL 88	ALL 110

Për të marrë pjesë në promovion konsumatorët duhet të blejnë një nga produktet e sipërpërmendura, të skanojnë QR në paketim ose të hyjnë në aplikacionin “Coca-Cola Play & Win Prizes” dhe të krijojnë një llogari me të dhenat e tyre, pa kosto. Me pas konsumatori duhet të regjistrohet me të dhenat personale duke hyrë tek paneli kryesor ku duhet të ngarkojë faturën fiskale nëse dëshirojnë të behet pjesë e këtij shorteu. Një konsumator ka të drejtë të marrë pjesë me shumë se një herë.

Shoqëria e cila do të menaxhojë, monitorojë website dhe ku do të behet perzgjedhja rastesore e fituesve per kete promovion eshte Agjensia IUP LABS me seli ne adresen: Rr.Themistokli Germenji, Nr.1, 1001, Tirane, Shqiperi.

Mekanizmi i promovionit “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” konsiston në një kombinim të formulave “Bëj blerje të një produkti Coca-Cola Origjinale në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L , Coca-Cola Zero në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Orange në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Orange Zero në paketimet kanaçe 330ml, shishe PET 1.5L, Fanta Exotic në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L dhe PET 2L, shishe Qelq RGB 0.25L, Fanta Lemon në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L dhe PET 1.5L, Sprite në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, shishe PET 0.45L, PET 0.9L, PET 1.5L, shishe Qelq RGB 0.25L, Schweppes Indian Tonic në paketimet kanaçe 150ml, kanaçe 330ml, PET 0.9L, shishe Qelq RGB 0.25L, Schweppes Bitter Lemon në paketimet kanaçe 330ml, PET 0.9L, Schweppes Grape Fruit në paketimin kanaçe 330ml, Schweppes SodaWater në paketimin kanaçe 330ml, Powerade Orange në paketimin PET 0.5L, Powerade Mount Blast në paketimin PET 0.5L, Powerade Citrus në paketimin PET 0.5L dhe apliko per t’u bere pjese e shorteut “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” për të fituar dhurata.

Për të marrë pjesë në promovionin “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” dhe për të fituar çmimet e vëna në dispozicion nga CCBS, pjesëmarrësit duhet të ndjekin udhëzimet vijuese të përcaktuara në këtë rregullore:

- Konsumatori duhet të jetë mbi 18 vjeç.
- Konsumatori duhet të blejë një nga produktet Coca-Cola Origjinale, Coca-Cola Zero, Fanta Orange, Fanta Orange Zero, Fanta Exotic, Fanta Lemon, Sprite, Schweppes Indian Tonic, Schweppes Bitter Lemon, Schweppes Grape Fruit, Schweppes SodaWater, Powerade Orange, Powerade Mount Blast, Powerade Citrus, në paketimet e sipërcituara, pjesë e kësaj Loje Promocionale.
- Konsumatori duhet të hyjë në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes dhe të krijojë një llogari.
- Konsumatori duhet të plotësojë të dhënat e kërkuara në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes dhe të ngarkojë faturën fiskale ku të lexohet blerja e minimalisht një produkti Coca-Cola Origjinale, Coca-Cola Zero, Fanta Orange, Fanta Orange Zero, Fanta Exotic, Fanta Lemon, Sprite, Schweppes Indian Tonic, Schweppes Bitter Lemon, Schweppes Grape Fruit,

Schweppes SodaWater, Powerade Orange, Powerade Mount Blast, Powerade Citrus, ne paketimet e sipercituara, dhe të perfundojë regjistrimin.

- Loja promionale do të jetë e vlefshme: Nga data 08 Qershor 2026 - 17 Korrik 2026.
- Hedhja e shorteut per perzgjedhjen e 6 fituesve do te behet 1 here ne jave, për 6 javë rradhazi, në praninë e një noteri publik ose te As/Noterit te autorizuar nga CCBS.
- Datat dhe orari i hedhjes se shorteut do te jene:
  1. 17 Qershor 2026 ora 10:00
  2. 24 Qershor 2026 ora 10:00,
  3. 1 Korrik 2026 ora 10:00,
  4. 8 Korrik 2026 ora 10:00,
  5. 15 Korrik 2026 ora 10:00,
  6. 22 Korrik 2026 ora 10:00.
- 6 Fituesit do te perzgjidhen ne 6 jave. Për shorteun e fundit do te jene pjese te gjithe aplikuesit pjesemarrës pergjate gjithë kohezgjatjes se shorteut dhe fituesi i perzgjedhur do fitoje nje Televizor Hisense si dhe topin zyrtar Adidas te Fifa.
- Fituesit do te zgjidhen ne menyre rastesore. Noteri do të certifikojë me anë të një procesverbali, i cili do të mbahet në momentin e hedhjes së shorteut dhe përzgjedhjes së fituesit.  
Ky procesverbal do të firmoset nga personat e pranishëm të cilët do të jenë; një punonjës i autorizuar nga CCBS, një punonjës i autorizuar nga Agjensia IUP LABS, një punonjës i autorizuar nga Autoriteti Mbikqyrës i Lojrave te Fatit, një inspektor i autorizuar nga Drejtoria e Tatimet si dhe Noteri Publik dhe/ose As/Noterit te autorizuar nga CCBS.
- Ditët e pushimit do të zëvendësohen nga dita parardhëse ose pasardhëse.
- Vendi ku do të hidhet shorteu për zgjedhjen e fituesit do te jete prane Agjensise IUP LABS me **adrese: Rr.Themistokli Germenji, Nr1, Tirane, 1001, Shqiperi.** Mënyra e perzgjedhjes së fituesit do të jetë rastësore nga sistemi. Do të përzgjidhen në mënyrë rastësore 6 persona fitues cdo jave. Fitues i një shorteu do te konsiderohen personi i parë, numrat e tjerë do të mbahen rezervë.

Gjatë kohëzgjatjes së këtij promovioni, konsumatorët do të kenë mundësinë të fitojnë në total:

- 7 dhurata në javë per 6 javë, 6 fitues në total:
- Vlera totale e dhuratave është si më poshtë:

Përshkrim	Sasi (cope)	Dhurata e lojes promionale	
		Cmim/njësi ne Leke, pa TVSH	Vlera totale e dhuratave ne Leke pa TVSH
Televizor Hisense	6	30,750 ALL	184,500 ALL
Topi Zyrtar Adidas	1	285,573.75 ALL**	285,573.75 ALL**

\*\*Vlera 3,500 USD konvertuar me kursin e këmbimit: 1 USD = 81.59 lekë.

\*Çmimi **nuk është** i konvertueshem në para.

5. Numri i parashikuar i pjesëmarrësve në promovionin “Loja Promionale Fifa World Cup” është rreth ~2 milion.

Shpërndarja e dhuratave do të bëhet në ambientet e CCBS. Fituesit mund të tërheqin dhuratën nga e Hëna në të Premte, nga ora 10:00-16:00 nga data 21 Qershor 2026 deri më 31 Korrik 2026. Tërheqja e dhuratës mund të kryhet vetëm me paraqitjen e dokumentit të identifikimit të fituesit. Në momentin e marrjes së dhuratës, Fituesi duhet të nënshkruaje procesverbalin e marrjes në dorëzim të dhuratës.

Fituesi duhet të paraqitet ne CCBS per terheqjen e dhuratës brenda një harku kohor prej 10 ditë pune nga data e shpalljes fitues. Nëse Fituesi nuk do të paraqitet brenda afatit ditor prej 10 ditë pune, për të tërhequr dhuratën, ai pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim ndaj CCBS, lidhur me dhuratën e përfutur, pasi ai humb të drejtën si fitues i këtij Promocioni dhe CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës të përzgjedhur në të njëjtën ditë me fituesin që ka refuzuar të tërheqë dhuratën.

Pjesëmarrës në shorte do të jenë të gjithë konsumatorët që kanë aplikuar në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes për t’u bërë pjese e lojës promionale Fifa World Cup gjatë periudhës së promovionit: 08 Qershor 2026 - 17 Korrik 2026.

Fituesi do të:

- a) Njoftohet me email brenda ditës së hedhjes së shorteut. Nëse fituesi nuk përgjigjet në emailin e dërguar brenda 5 dite pune ose dergimi i e-mailit deshton, atëherë CCBS-së i lind e drejta të shpallë fitues personin pasardhës.
- b) Në rast se fituesi nuk përgjigjet në email pranon se nuk do të ketë asnjë pretendim për dhuratë dhe humbet të drejtën si fitues i këtij Promocioni.
- c) Duhet të dergoje me email kredencialet e plota si: emër, mbiemër, atësi, numrin e kartës së identitetit, qytetin dhe adresën e saktë të banimit.
- d) Të gjitha të dhënat personale do të përpunohen nga CCBS dhe NV Coca-Cola Services SA,(CCS)vetëm për qëllimin e këtij promocioni, vetëm pas miratimit të kushteve dhe termave të privatisise për përpunimin e këtyre të dhënave nga ana e aplikuesve në llogarinë e krijuar e sipas rregullores përkatëse dhe do të shkatërrohen brenda 14 ditëve nga përfundimi i dorëzimit të dhuratës, sipas ligjit në fuqi, duke mos lejuar humbjen, ndryshimin, përhapjen e pa-autorizuar ose ndërhyrjen të të dhënat personale të transmetuara, ruajtura apo përpunuara.Të dhënat personale të mbledhura nga NV Coca-Cola Services SA,(CCS), CCBS dhe Agjensia IUP LABS në kuadër të këtij promocioni sipas kushteve të kësaj rregullore dhe kushteve të privatisise të pranuar nga fituesit apo pjesëmarrësit në momentin e plotësimit të dhënave të kërkuara në aplikacionin Coca-Cola Play & Win Prizes, do të trajtohen në përputhje me Ligjin “**Nr.124/2024** “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- e) CCBS nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dëm financiar apo jofinanciar (përfshirë dëmin apo fitimin e munguar) që mund të rezultojë si pasojë e pjesëmarrjes në promocionin “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” përjashtuar përgjegjësinë ligjore të CCBS.
- f) Të gjithë pjesëmarrësit në lojën promocionale duhet të jenë në dijeni se të dhënat e fituesve në këtë lojë promocionale do të shpallen në faqen zyrtare të lojës promocionale “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” dhe bien dakord që të dhënat e tyre të jenë publike në faqen zyrtare pas shpalljes së fituesit deri më datë 31 Korrik 2026.
- g) Pjesëmarrësit në këtë promocion nuk kanë të drejtë të kërkojnë çmim në sasi më të madhe, apo çmim të ndryshëm nga ai i përcaktuar nga subjekti organizues i fushatës sipas kësaj rregulloreje. Çmimet e mësipërme nuk janë të konvertueshme në para. Duke marrë pjesë në këtë promocion, pjesëmarrësit detyrohen të respektojnë këtë rregullore.
- h) Promocioni “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” mund të ndërpritet në rast force madhore dhe/ ose Fatkeqësie Natyrore (rrethana të cila Shoqëria nuk mund t'i kishte parashikuar apo influencuar), përfshirë pamundësinë e CCBS për të vazhduar promocionin “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” për arsye që nuk varen nga vullneti i saj. CCBS do të informojë konsumatorët me mjetet e duhura në rast ndërprerje të promocionit “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” duke dhënë edhe arsyet e kësaj ndërprerjeje. Në raste të tilla, CCBS nuk do të ketë detyrimin për të dëmshpërblyer pjesëmarrësit për çdo shpenzim lidhur me pjesëmarrjen e tyre në promocion.
- i) Promocioni “**Loja Promocionale Fifa World Cup**” është një promocion që i drejtohet publikut dhe bazohet në nenet 661, 665, 667 paragrafi i parë dhe i tretë, 670 e 671 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Organizimi i **Loja Promocionale Fifa World Cup** bëhet në përputhje me Ligjin 155 /2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 75/2018 datë 25.10.2018 si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 196, datë 15.3.2017 “Përcaktimin E Mënyrave, Formave, Kriteve Dhe Rregullave Për Organizimin E Lojërave Të Fatit Promocionale”. Personat që sipas parashikimeve të kësaj rregullore kanë të drejtë të tërheqin çmimet e vëna në lojë, nëse hasin pengesë në tërheqjen e tyre mund të paraqesin çdo ankesë apo informacion në numrin e tel: +35545606060 ose në adresën e e-mailit: [info@cocacola.al](mailto:info@cocacola.al).
- j) Coca-Cola, Coca-Cola Zero, Fanta, Sprite, Powerade dhe Schweppes janë marka të regjistruara të “The Coca-Cola Company”.
- k) Këto rregulla do të botohen pjesërisht në materialet promocionale dhe plotësisht në website (www.coca-cola.com).